



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE
BALLKANIKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Fonetikë Turke

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 15 leksione / 25 seminare

Viti / Semestri : Viti I, Semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor – Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Turk

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Të marrë njohuritë bazë të fonetikës turke. Të njohë terminologjinë e lëndës së fonetikës. Të shpjegojë drejt shembujt e ndryshëm sipas rregullave fonetike të turqishtes. Të lexojë me theksin dhe intonacionin e duhur. Të pasurojë njohuritë e tij duke shfrytëzuar edhe literaturën shtesë për lëndën e fonetikës.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të dallojë lehtësisht rregullat fonetike në gjuhën turke.
2. Të punojë gjatë orëve të seminareve me materialin në turqisht.
3. Të praktikojë leximin e fjalëve me theksin dhe intonacionin e duhur.
4. Të përgatisë me sukses një detyrë kursi në fund të semestrit për rregullat e fonetikës.

Rezultatet e pritshme:

1. Studentët do të jenë në gjendje të identifikojnë dhe analizojnë tingujt fonetike të gjuhës turke, duke dalluar sistemin e zanoreve dhe të bashkëtingëlloreve sipas karakteristikave fonetike dhe fonologjike të kësaj gjuhe.
2. Do të zotërojnë rregullat fonetike të gjuhës turke, përfshirë harmoninë e zanoreve (rregulla e madhe dhe e vogël), rregullat e bashkëtingëlloreve dhe ndryshimet tingullore në fjalët e leksikut vendas dhe të huazuar.
3. Do të përvetësojnë njohuri mbi theksin, intonacionin dhe diksionin në turqisht, duke zhvilluar aftësinë për t'u shprehur me qartësi dhe saktësi në nivelin fonetik të gjuhës.